REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT

# KONTRATË PËR PUNË

*KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson Z. Gëzim Ademaj, U.D. I menaxher-it i Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;*

*Dhe*

*Arlinda Miranaj B.I. – NPN "LINDI" Komuna e Istogut , të cilën e perfaqëson z. Arlinda Miranaj, me Nr. Unik i Rexh. Biznesi, 811225243 (ne vazhdim "Kontraktuesit"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:*

*TITULLI I KONTRATËS:*

*NDËRTIMI I LIQENIT ARTIFICIAL NË BAJSHE*

| | |
|---|---|
| *Nr. I prokurimit* | *633-20-6675 / 5-2-1/ C106* |
| *Nr. I brendshëm* | *633 / 020 / 106 / 521* |

## *Neni 1 Lënda*

*1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:*

*NDËRTIMI I LIQENIT ARTIFICIAL NË BAJSHE*

## *Neni 2 Çmimi*

*2.1 Çmimi i punëve per aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I LIQENIT ARTIFICIAL NË BAJSHE është: 12.143,56 dhe me fjalë: /Dymbëdhjetmijëenjëçindekatërdhjetetre-56 /100 €***

*2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet*

*të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit te kontratës.*

*2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.*

***Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës***

*3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:*

*Marrëveshja e kontratës;*
*Kushtet e Veçanta të Kontratës;*
*Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;*
*Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;*
*Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);*
*Plani për menaxhimin e kontratës*

*3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.*

***Neni 4 Afati i përmbushjes së kontratës:***

***4.1. Të gjitha punimet sipas kësajë kontrate do të përfundojnë me datë, 23. 11. 2020***

***Neni 5 Ndërprerja e kontratës:***

***5.1 Kjo kontratë mund të shkëputet kurdo që kontraktori nuk i respekton kushtet e pergjithshme dhe te veqanta te kontratës te parapara ne dosjen e tenderit, dhe kur per një gje te tillë plotesohen këto kushte.***

***Neni 6 Komunikimet***

*6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe*

*6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe* *duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për*

*Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.*

*6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.*

*6.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.*

*6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.*

***Për: Autoritetin Kontraktues:***
***Komuna e Istogut***

***Për: Kontraktuesin:***
***Arlinda Miranaj B.I. NPN "Lindi"***

| | | | |
|---|---|---|---|
| ***Emri:*** | ***Gëzim Ademaj*** | ***Emri:*** pcī | ***Arlinda Miranaj*** |
| ***Pozita:*** | ***U.D. Menaxher-it të Prokurimit*** | ***Pozita:*** | ***M e n a xh e r*** |
| ***Nënshkrimi:*** | [signature] | ***Nënshkrimi:*** | [signature] |
| ***Data:*** | 23. 11. 2020 | ***Data:*** | 23. 11. 2020 |
| ***Vu la*** | REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPSTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO | ***V u l a*** | LINDI 70803743 ISTOG |

# PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---|---|---|
| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë:GJUHA SHQIPE. |
| Siguria e ekzekutimit | 10.1 | Shume e sigurisë së ekzekutimit është *10% e vlerës së përgjithshme të kontratës në afat prej 30DITE ME GJATE SE PERFUNDIMI I KONTRATES.* |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2 | Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite. |
| Programi | 12.1 | Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda *5* ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. |
| | 12.2 | Periudha për Programin e azhurnuar është *5* ditë |
| Fillimi i punëve | 17.1 | Data e fillimit do të jetë 5 dite nga nënshkrimi i kontrates |
| | 17.2 | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: 1muaj. |
| Dëmet e likuiduara | 19.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë *0.25%* për ditë por jo më shume se 10% e vlerës së kontratës. |
| Regjistri i punës | 20.1 | Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor |
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | Menaxheri i Projektit është *i caktuar me vendim të ZKA* |
| Parapagimi | 26.1 | Shuma e Parapagimit është: ska |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 42.2 | Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata. |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë |

| Sanimi I rezervuarit,hapja e rruges dhe vendosja e kroit ne Bajshe | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Pozicioni | Njësia | Sasia | Çmimi njësi | Çmimi total |
| | | | | € | € |
| 1 | Punet e Hidroizolimit te Rezervuarit nga ana e mbrendshme- Pastrimi dhe Trajtimi i siperfaqeve me mjete abrasive –Pergaditja e nenshtreses dhe hidroizolimi | | | | |
| 1.1 | Pompimi I ujit egzistues ne rezervuar(3metra thellesi deri te shtresa e sedimentit),germimi me dore I materialeve te sedimentuara(dheut dhe gureve)ne pjesen fundore te rezervuarit 3m thellesi(material I sedimentuar),9 metra diametri.ngarkimi dhe largimi deri ne deponi te percaktuar nga menaxheri.Verejtje:Materiali i cili duhet te largohet eshte parapare permes Vrimes 1mx1m,e tere puna duhet te realizohet me dore. | m³ | 381.00 | 1.00 | 381.00 |
| 1.2 | Nenshtresa duhet te pergaditete me njeren nga metodat e pranuara abrasive , siç jane : Zallitje , trajtimi me uje nen presion te larte (400 bar), grryerje , trajtimi me furça te çelikut , e tj. Me qellim te largimit te pluhurit, mbetjeve te vajrave , pjeseve te palidhura dhe te lidhura dobet , yndyrave, ngjyrave dhe supstanca tjera te cilat pengojne athezionin e materialit Hidroizolues per baze ( Nenshtrese ). Njekohesisht me kete pergaditje te nenshtreses plasaritjet e betonit qe jane vetem siperfaqesore do te zhduken kurse ato strukturore do te behen me te kjarta per injektim | m² | 396.66 | 1.00 | 396.66 |
| 1.3 | Furnizimi me material dhe Injektimi I mureve ne pjesen e plasaritjeve te brendshme te objektit sipas pershkrimit(dhe pikave te percaktuara nga projektuesi):<br>- Hapja e vrimave me maqine dhe pastrimi I tyre<br>- Montimi I Pankerit<br>- Injektimi I Pankerit me Sika Injection 101<br>- Injektimi I Pankerit me sika injection 201 | Cope | 690.00 | 2.00 | 1,380.00 |
| 1.4 | Furnizimi me material dhe punimi I sistemit te mbylljes se nderprerjeve te betonit , plasaritjeve , dhe lidhjeve pllake mure , mure -mure te betonit me sistemin Combiflex. | m | 96.52 | 5.00 | 482.60 |
| 1.5 | Furnizimi me material dhe Hidroizolimi I dyshemese dhe mureve te objektit me Llaq Hidroizolues fleksibel, njekomponenet , I perforcuar me fibra ne baze te çimentos se modifikuar , me shtesa special te polimereve rezistente ne alkale, , Sika Lastic 1K. | m² | 396.66 | 5.00 | 1,983.30 |
| | | | Gjithsej 1: | | 4,623.56 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Punet e Hidroizolimit te Rezervuarit nga ana e mbrendshme- Pastrimi dhe Trajtimi I siperfaqeve me mjete abrasive –Pergaditja e nenshtreses dhe hidroizolimi | | | | |
| 2 | Hapja dhe rregullimi I rruges | | | | |
| 2.1 | Prerja e drunjeve dhe shkurreve(me nxjerrje te cungave dhe rrenjeve ne dy anët e trupit të rrugës) Ø10-Ø80cm, me bartje ne deponi ne largesi min. 5 km. | m' | 600.00 | 1.00 | 600.00 |
| 2.2 | Gërmimi i dheut i kategorisë së V- VI-të (formacion I fortë)me deponim ne krahun e rruges se planifikuar per mbushje | $m^3$ | 1,200.00 | 1.00 | 1,200.00 |
| 2.3 | Gërmimi I formacionit shkëmbor(Kat VII-VIII),ne vende te caktuara edhe me cekan, te siperfaqes në mënyrë që të krijohet zgjerimi I e rrugës ashtu siq eshte parapar në projektin ideor | $m^3$ | 70.00 | 10.00 | 700.00 |
| 2.4 | Formësimi dhe ngjeshja e nenbazes se trupit te rruges me ngjeshmeri 30MN/m2 | $m^2$ | 2,400.00 | 0.50 | 1,200.00 |
| | | | Gjithsej 2: | | 3,100.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Punet e Hidroizolimit te Rezervuarit nga ana e mbrendshme- Pastrimi dhe Trajtimi i siperfaqeve me mjete abrasive –Pergaditja e nenshtreses dhe hidroizolimi | | | | |
| 3 | OBJEKTET DHE UJESJELLSI | | | | |
| 3.1 | Germimidhe mbulimi I kanalit me kategori te dheut VII-VIII per vendosjen e gypit te ujesjellsit(b=40cm,ne pjesen kyqese h=3m) | m | 600.00 | 1.00 | 600.00 |
| 3.2 | Furnizimi me rere dhe mbulimi I gypit | $m^3$ | 96.00 | 5.00 | 480.00 |
| 3.3 | Furnizimi dhe motimi I gypit PE ø 5/4 | m | 600.00 | 1.00 | 600.00 |
| 3.4 | Furnizimi me material dhe Punimi I kroit me te gjitha elementet percjellese | cope | 1.00 | 500.00 | 500.00 |
| 3.5 | Furnizimi me material armimi(ø8/15).kallepimi rrethor dhe betonimi(klasa C30/37) I pllakes se siperme t=5cm,betoni te jete me fraksion max.11mm dhe ne perberje me aditiv hidrofobik | $m^2$ | 64.00 | 35.00 | 2,240.00 |
| | | | Gjithsej 3: | | **4,420.00** |

***REKAPITULLIMI***

| | | |
|---|---|---|
| ***1*** | ***Punet e Hidroizolimit te Rezervuarit nga ana e mbrendshme- Pastrimi dhe Trajtimi I siperfaqeve me mjete abrasive –Pergaditja e nenshtreses dhe hidroizolimi*** | ***4,623.56*** |
| ***2*** | ***Hapja dhe rregullimi I rruges*** | ***3,100.00*** |
| ***3*** | ***OBJEKTET DHE UJESJELLSI*** | ***4,420.00*** |
| | ***TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT:*** | ***12,143.56*** |